



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE

Numri i Ceshtjes : 31155-00734-80-2020 **Data e Regjistrimit :** 10/02/2020
Numri i Vendimit: 80-2020-2428 **Data e Vendimit :** 16/10/2020

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE E PERBERE NGA:

GJYQTAR: {...}

SEKRETARE: {...}

Sot me date 16/10/2020mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore geshtjen civile qe i perket :

Padites {...} shpk I Paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industrial Tirane I Paditur Shoqeria {...}shpk

Objekti:Konstatimi i paligjshmerise dhe shfuqizimi i vendimit nr 257/11 prot. date 17.12.2019 te Bordit te Apelimit te pales se paditur DPPI. Lenia ne fuqi e vendimit nr.257/6 prot date 25.07.2019 te Dhomes per shfuqizim/zhvleresim te DPPI. Detyrimi i te paditurit DPPI te shfuqizoje te gjitha rregjistrimet e kesaj marke per te paditurin {...}shpk, si dhe te publikoje vendimin gjyqesor ne buletin e publikuar prej saj. Ndalimi i perdorimit apo publikimit te markes se rregjistruar me emrin NEW GENERATION nga i padituri {...}shpk.

Baza Ligjore:Ligji 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative" i ndryshuar.

Gjykata ne perfundim te hetimit gjyqesor, pasi administroi provat shkresore, ne seancen gjyqesore te dates 16.10.2020, degjoi pretendimet perfundimtare te pales paditese qe kerkoi pranimin e kerkesepadise sipas objektit, palen e paditur qe kerkoi rrezimin e kerkesepadise si dhe pasi e shqyrtoi dhe analizoi geshtjen ne teresi lidhur me ligjshmerine dhe mbeshtetjen ne prova te kerkesepadise, Gjykata Administrative;

VEREN :

Veren:

Se, paditesi shoqeria Venere shpk, i eshte drejtuar fillimisht Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, me kerkesepadine e mesiperme, me pale te paditur D.P.P.I, dhe me objekt: "Shfuqzimin e aktit administrativ (...)". "Zgjidhjen e pasojave, Detyrimin e pale se paditur te rregjistroje(...).

A. Rrethana te Faktit.

Paditesi shoqeria "Venere" sh.p.k, eshte shoqeri e te drejtes shqiptare me perfaqesues ligjor shtetasen E.Kapllakci. Paditesi eshte regjistruar prane QKB dhe eshte pajisur me NIPT. Referuar ekstraktit te qkb paditesi eshte me status pezulluar por ka per objekt veprimtarie formimin profesional ne fsuhen e parukerise. Pala paditese ka aplikuar prane DPPI per te cregjistruar marken Nevv Generation rregjistruar ne emer te te paditurit {...}. Dhoma per shfuqzimin prane DPPI me vendimin nr. 257/6., prot date 25.07.2019, ka pranuar kerkesen e Venere shpk. Mbi ankimin e subjektit Arilta B Dhoma e Apelimit prane DPPI ka marre vendimin nr. 257/11., date 17.1.2019, per pezullimin e procedures administrative deri ne dhenien e vendimit perfunditar nga Gjykata e Larte, lidhur me nje mosmarreveshje mes ortakeve te shoqerise Venere shpk. Nisur sa me siper, pala paditese i eshte drejtuar me kerkesepadi gjykates, duke kerkuar, shfuqzimin e vendimit te Dhomes se Apelimit si dhe detyrimin e pales se paditur DPPI per cregjistrimin e markes Ne Generation per te paditurin Arilta B shpk.

B. Ligji i zbatueshem.

K.Pr.Administrative, miratuar me ligjin 8485/1999, neni 66, parag.1, parashikon se; "Nese organi publik qe zhvillon proceduren perballat me nje geshtje, zgjidhja e se ciles eshte parakusht per zgjidhjen e procedures dhe qe perben nje geshtje ligjore te pavarur, per zgjidhjen e se ciles eshte kompetent nje gjykate ose organ tjeter ("geshtja paraprake"), organi publik qe zhvillon proceduren administrative pezullon proceduren deri ne marrjen e njevendimi te formes se prere per geshtjen paraprake dhe njofton palen ne lidhje me kete.";

Ligji nr. 9947, date 07.07.2008 "Per pronesine industriale" te ndryshuar nenit 143, pika 2, germa "b" Marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajo duhet te deklarohet e pavlefshme kur":

b) eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, e cila mbrohet per mallra apo sherbime identike ose te ngjashme dhe kur, per shkak te njelloshmerise ose te ngjashmerise, ekziston mundesia e shkaktimit te konfuzionit te publiku, ku perfshihet edhe mundesia e bashkelidhjes me marken e meparshme;

C. Lidhur me parakushtet procedurale

Lidhur me juridiksionin dhe kompetencen: nga analiza e akteve shkresore Gjykata konkludon se geshtja objekt gjykimi, i perket juridiksionit gjyqesor administrativ dhe eshte ne kompetencen lendore, funksionale dhe territoriale te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane. Nga palet nuk pati pretendime apo prapesime per juridiksionin dhe kompetencen.

- *Lidhur me legjitimimin:* Ne kuptim te ligjit procedural, palet ne gjykim kane legjitimim substancial atehere kur ne cilesine e pales paditese paraqitet subjekti te cilit i eshte cenuar, mohuar apo e shkelur e drejta (*legjitimimi aktiv*), ndersa ne cilesine e pales se paditur paraqitet subjekti i cili e cenon, mohon ose shkel kete te drejte (*legjitimimi pasiv*). Bazuar ne nenin 32/a te K.Pr.Civile, si dhe nenin 15/a te LGJA-se, paditesi legjitimohet per t'iu drejtuar me padi Gjykates per te kerkuar rivendosjen e se drejtes se pretenduar, si te shkelur apo cenuar nga pala e paditur, jane *aktet e te paditurit qe* potencialisht mund te kene cenuar drejtperdrejt interesat e tij. Po ashtu, pala e paditur, legjitimohet pasivisht, pasi eshte pikerisht DPPI ne cilesine e organit publike, qe ka nxjerre aktin e kundershuar, i cili potencialisht mund te cenojne te drejtat dhe pritshmerine e ligjshme te paditesit. Sa me siper, si paditesi ashtu dhe pala e paditur gezojne respektivisht legjitimitetin aktiv dhe pasiv ne kete gjykim.

- *Lidhur me shterimin e rruges administrative:* Ne reference te nenit 16/1 te LGJA-se, parimisht qe te mund te ankimohet gjyqesish nje veprim administrativ, paraprakisht duhet ezauruar rruga administrative, ne te kundert Gjykata vendos mospranimin e padise. Megjithate, ligjvenesit ka parashikuar ne paragrafin e dyte, rastet kur ankimi administrativ nuk eshte parakusht per marrjen ne shqyrtim te ankimit nga Gjykata. Nder te tjera, parashikohet se behet perjashtim nga parimi i me siper ne rastet kur ligji nuk parashikon organ me te larte per paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi me i larte administrativ nuk eshte konstituuar apo rastet kur ligji parashikon shprehimisht te drejten per t'u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtperdrejt ne Gjykate. Ne rastin objekt gjykimi aktet e pales se paitutr jane te kundershueshme dpd ne gjykate.

Lidhur me afatin e ngritjes se padise: Gjykata pasi verifikoi ato kryesisht rrezultoi se padia eshte ne rrespekt te afateve procedurale. Ne keto rrethana, Gjykata si konkluzion vlereson se padia objekt gjykimi ploteson elementet dhe kushtet formale te padise ne gjykimin administrativ, per pasoje geshtja duhet te pranohet per shqyrtim.

D. Vleresimi i Gjykates.

Ne thelb, kontrolli gjyqesor mbi veprimtarine e organeve te administrates publike, konsiston ne mbikeqyrjen e vendimmarrjes administrative, me qellim mbrojtjen e te drejtave dhe interesave te individeve dhe mirefunksionimin e shtetit te se drejtes. Gjykata pasi analizoi gjithe provat e marra gjate hetimit gjyqesor dhe pasi vleresoi bazueshmerine ne ligj dhe prova te pretendimeve te paditesit arriti ne konkluzionin se kerkesepadia eshte pjeserisht e bazuar ne ligj dhe prova. Konkretisht gjykata e gjen te bazuar vetem pikene pare te objektit te padise, nderkohe qe vlereson te pabazuar kerkimet e tjera. Gjykata arrin ne kete konkluzion si rrezultat i analizes ligjore dhe faktike si poshte vijon;

Gjykata vlereson se pala e paditur ka gabuar kur ka vendosur pezullimin e procedures administrative deri ne dhenien e vendimit perfundimtar nga Gjykata e Larte, lidhur me nje mosmarreveshje mes organeve te paditesit Venere shpk. Ne rastin qe pret te shqyrtohet ne Gj.Larte, objekt shqyrtimi jane konfliktet mes ortakeve te shoqerise, ndersa prane Dhomes se Apelimit ne DPPI objekt shqyrtimi eshte vendimi i Dhomes se Zhvleresimit per cregjistrim te nje marke, vendim i cili eshte ne interes te pales paditese Venere shpk. Pra gjykimi i cili eshte vleresuar si shkak pezullues nuk ndikon fare ne procesin administrativ qe eshte ne pritje te shqyrtimit ne Dhomen e Apelimit, pasi kerkuesi prane organit administrativ Venere ka vepruar gjithsesi ne interes te shoqerise. K.Pr.Administrative parshikon shprehimisht rastin kur mund te pezullohet nje procedim administrativ dhe konkretisht ne nenin 66, pika 1, parashikohet se; "Nese organi publik qe zhvillon proceduren perballat me nje geshtje, zgjidhja e se ciles eshte parakusht per zgjidhjen e procedures dhe qe perben nje geshtje ligjore te pavarur, per zgjidhjen e se ciles eshte kompetent nje gjykate ose organ tjeter ("geshtja paraprake"), organi publik qe zhvillon proceduren administrative pezullon proceduren deri ne marrjen e njevendimi te formes se prere per geshtjen paraprake dhe njofton palen ne lidhje me kete." Ky trup gjykues vlereson se ne rastin konkret, zgjidhja e mosmarreveshjes ne Gj.Larte, nuk perben dhe nuk duhet te vleresohej si parakusht per zgjidhjen e procedimit administrativ. prane Dh.Apelimit eshte ne shqyrtim rastin nese duhet te behet cregjistrimi ne emer te Arilta B apo jo. Kjo ceshtje eshte thellesisht ligjore dhe ska lidhje apo koneksitet me perfundimin egjykimit ne Gj.Larte ku objekt gjykimi jane mosmarreveshjet mes ortakeve te Venere shpk. Per sa me siper gjykata cmon se vendii i Dhomes se Apelimit prane DPPI eshte i pabazuar ne ligj e ne fakt, si i tille duhet te shfuqzohet.

Lidhur me kerkimet e tjera te padise, gjykata cmon se paditesi nuk legjitimohet ti kerkoje ne kete gjykim sa kohe qe nuk ka nje vendim perfundimtar te organit administrativ, apo sa kohe qe ska kaluar afati i parashikuar ne ligj brenda te cilit organi duhet te shprehet me vendim. Bordi i Apelimit ne DPPI ska dale me vendim perfundimtar, por me nje vendim te ndermjetem per pezullim procedure. Per pasoje paditesi nuk ka interes te ligjshem per te mbrojtur ne kete proces lidhur me kerkimet e tjera. K.Pr.Administrative, neni 136 percaktohet se: "1. Ankimi ndaj nje akti administrativ shqyrtohet, ne radhe te pare, nga vete organi publik kompetent, me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne ligj. 2. Organi publik kompetent fillimisht shqyrton nese ankimi eshte i pranueshem dhe vetem nese ankimi eshte i pranueshem, shqyrton ligjshmerine dhe pershtatshmerine e aktit administrativ te ankimuar. Nese eshte e nevojshme, organi publik

kompetent mund te kryeje hetime administrative shtese. 3. Nese anulimi, shfuqizimi ose ndryshimi i aktit administrativ te ankimuar apo nxjerrja e aktit te refuzuar do t'i shkaktonte dem nje pale tjetere, organi kompetent duhet t'i jape asaj mundesine per t'u degjuar [...]"

Akti administrativ objekt gjykimi i cili si mw lart u analizua vlerwsohet i pabazuar nw ligj, nuk eshte vendim perfundimtar dhe nuk i pergjigjet themelit te kerkimit te Paleve, por eshte nje vendim i marre ne zbatim te nenit 66 K.Pr.Administrative, ku "pezullimi" percaktohet si nje veprim procedural vleresimi dhe eshte vendim i ndermjetem, konkretisht: "Nese organi publik qe zhvillon proceduren perballet me nje geshtje, zgjidhja e se ciles eshte parakusht per zgjidhjen e procedures dhe qe perben nje geshtje ligjore te pavarur, per zgjidhjen e se ciles eshte kompetent nje gjykate ose organ tjetere ("geshtja paraprake"), organi publik qe zhvillon proceduren administrative pezullon proceduren deri ne marrjen e nje vendimi te formes se prere per geshtjen paraprake dhe njofton palen ne lidhje me kete.". Ne kuptim te nenit 67/1 K.Pr.Administrative, ky vendim eshte i ndermjetem dhe jo perfundimtar, si percaktohet se: "Organi publik, qe eshte kompetent per marrjen e vendimit perfundimtar, mund te marre edhe vendime te ndermjetme, kur gjykohet se mosmarrja e masave te caktuara do te shkaktonte nje dem te rende e te pariparueshem mbi interesin publik, apo te drejtave ose interesave te ligjshem te paleve.". Si pwrfundim pwr arwsyet e sipwrcituara Pala Paditese, nuk legjitimohet te kerkoje qe me shfuqizimin e ketij vendimi te lihet ne fuqi vendimi i Dhomes per Shfuqizim/Zhvleresim i DPPI.

Shpenzimet gjyqesore u lihen paleve sic jane bere. Konform nenit 65, 66 te ligjit nr. 49/2012, ky vendim eshte i ekzekutueshem ne menyre te detyrueshme mbi kerkesen e kreditorit sapo te konfirmohet nga autoritetet gjyqesore marrja forme te prere.

Per keto arsye

Baza Ligjore:

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane, bazuar ne nenet 126, 306-310 te K.Pr.Civile, si dhe ligjit 49/2012, ndryshuar;

VENDOSI:

Vendosi:

- €€€€€€€€ Pranimin e pjeseshem te kerkese padise se paditesit Venere shpk.
- €€€€€€€€ Shfuqizimin e Vendimit Nr. 257/11., prot, date 17.12.2019 te Bordit te Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme te DPPI dhe detyrimin e pales se paditur te shqyrtoje ne themel ankimin e subjektit {...} shpk.
- €€€€€€€€ Rrezimin e padise per pjesen tjetere te kerkimeve.
- €€€€€€€€ Shpenzimet gjyqesore sic jane bere.
- €€€€€€€€ Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda 15 diteve ne Gjykatën e Administrative te Apelit Tirane, duke filluar nga e nesermja e marrjes dijeni per vendimin e zbardhur.

U shpall ne Tirane, sot me date 16.10.2020.

SHPENZIMET GJYQESORE

Kerkesepadia	0
Taksa Gjyqesore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:

{...}